

VENDIM
Nr. 880, datë 30.10.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “KORÇË - QAFË PLOÇË (SHTESA)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Korçë - Qafë Ploçë (shtesa)”.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “arë”, “truall” dhe “kultura bujqësore”, me vlerë të përgjithshme shpro-nësimi prej 1 334 830 (një milion e treqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë) lekësh, nga të cilat:
 - tokë “arë”, me sipërfaqe 5 415 (pesë mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë) m², me vlerë 998 700 (nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind) lekë;
 - tokë “truall”, me sipërfaqe 97 (nëntëdhjetë e shtatë) m², me vlerë 144 530 (njëqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë;
 - “kultura bujqësore”, me vlerë 191 600 (njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëqind) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë “arë”, “truall” dhe “kultura bujqësore”, prej 1 334 830 (një milion e treqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infra-strukturës, zëri “Shpronësim”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
 6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.
 7. Pronarët e pasurive të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 e 7, të këtij vendimi.
 9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Korçë dhe Pogradec, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.
 10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Korçë dhe Pogradec të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.
 11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Korçë dhe Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
 AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
 SEKTORI SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR “KORÇË -
 QAFË PLLOÇË” (SHITESAT)

Nr.	PRONARI	ZK	Nr. Pas.	Lloji i pasurisë	Sip. totale	VLERËSIME T			Kultura bujqësore	VLERA TOTAL E (lekë)	Shënime
	Emri i pronarit					Sip (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lekë)			
1	Bashkëpronarët Hyko	3047	11\1	Arë	3000	2500	200	500000		500000	Konf. ZVRPP
2	Lytfi Dilaver Ibi	1387	325/45	Arë	1500	300	200	60000		60000	Konf. ZVRPP
3	Rami Nazmi Mulla	3047	11\3	Arë	2000	1847	200	369400		369400	Konf. ZVRPP
4	Esat Nazmi Mulla										
5	Myseret Nazmi Tollozhina										
6	Edmond Hasimllari	3553	52/27	Truall	1250	97	1490	144530		144530	Pritet konfirmimi
7	Urim Mukollari	3553	47/31	Arë	1789	75	212	15900		15900	Pritet konfirmimi
8	Andrea Baki Bakollari	3496	1600/21	Arë		170			79650	79650	Konf. ZVRPP
9	Miranda Islam Bakollari										
10	Baki Halil Bakollari	3496	166/20	Arë		256			111950	111950	Konf. ZVRPP
11	Avdulla Bektash Leka	2420	110/59	Arë	1610	267	200	53400		53400	Pritet konfirmimi
	TOTALI					5512		1143230	191600	1334830	